

PROPOZICIONET E GARAVE 2015/2016



PROPOZICIONET E GARAVE

TË SUPER LIGËS TË KOSOVËS (M&F)
STINORI 2015 / 2016

Neni 1.

Garat zhvillohen ne pëputhje me Rregullores se brendshme, Rregulloren e regjistrimit të klubeve dhe lojtarëve te volejbollit,Rregullores teknike ndërkombetare,Rregullores disiplinore dhe Propozicioneve te garave te FVK-ës dhe

Neni 2.

Pjesëmarrja në Super Ligat e Kosovës (M&F) është e kushtëzuar me pjesëmarrjen e ekipeve te juniorëve në garat zyrtare te organizuara nga FVK-ës.

Neni 3.

Garat zhvillohen ne dy pjesë, pjesa e rregullt e kampionatit dhe pjesa perfundimtare (nënkuptohet garat shtesë Play- Off)

Liga zhvillohet me sistem te nje fisht ,ku orari është bërë në bazë të numrave të ekipeve te caktuara me hudhjen e shortit dhe tabelës së Bergerit.

PLAY –OFF luhet me sistem :

Ekipi i plasuar ne vendin e parë ne perfundim të pjesës së rregullt të garave ,takohet me ekipin e katërt .(me dy fitore,përparsi tereni vendas për ekipin e plasuar më mirë).

Ndërsa ekipi i plasuar në vendin e dytë në fund të pjesës së rregullt,takohet me ekipin e plasuar ne vendin e tretë (me dy fitore përparësi tereni për ekipin e plasuar më mirë)

Ndeshja Finale e Play-Ofi-t, për Kampion te Kosovës,luhet ndërmjet fituesve të ndeshjeve gjysëm finale,në dy ndeshje të fituara,ku 1,2,dhe eventualisht ndeshja e 3 luhet ne fushën e ekipit më mirë të plasuar.

Ekipet e plasuara ne fund te Kampionatit ne vendin e tete (8-te) dhe te shtate(7),automatikisht bien ne nje range me te ulte te garave.

Play-outi

Ekipi I plasuar në vendin e 6 (gjashte) dhe 5 (peste) nga Super Liga luajne me vendin e 1 (pare) dhe 2 (dytë) nga Liga e pare ,pra vendi I pare me te gjashtin dhe vendi I dyte me te pestin me sistem te dy loje te fituara..

Neni 4.

Nëqoftëse ndonjëri nga klubet e Super ligës hjekë dorë nga garat,më së voni 15 ditë para fillimit të Kampionatit, liga do të plotësohet . Bordi i FVK-ës në bazë të autorizimeve, bjen vendim per plotësimin e së njejtës dhe ate na baze te rangimit te ligan perkatese

Neni 5.

Në ndeshjet e ligave të Kosovës, secila ekip i bartë shpenzimet e veta, ndërsa ekipi vendas i bartë shpenzimet e personave zyrtar.

Neni 6.

Numri i pikëve të fituara të ekipit në një ndeshje janë 3(tri)

Për çdo fitore të ndeshjes me rezultat 3:0 dhe 3:1 ekipi fiton tri pikë.

Për çdo fitore me rezultat 3:2 ekipi fiton dy pike

Për çdo ndeshje të humbur me rezultat 2:3 ekipi fiton një pike

Për çdo humbje me 0:3 dhe 1:3 ekipi nuk fiton pike (0)

Plasmani caktohet në bazë të pikave të fituara.

Në rast të numrit të barabart të pikave ,atëhere,plasmani caktohet:

- a) në bazë të numrit të ndeshjeve të fitura, fiton ekipi me më shumë ndeshje të fituar, nëse barazimi vazhdon, atëhere do të vendoset në bazë të koficientit të setave të fituar dhe të humbur. P.sh.
- b) Ekipi A ka fituar 12 sete dhe ka humbur 8 sete
Ekipi B ka fituar 14 sete dhe ka humbur 10 sete
Koficienti i ekipit A është $12:8 = 1.5$
Koficienti i ekipit B është $14:10 = 1.4$
Fiton ekipi me koficient më të madh \
- c) nëse barazimi vazhdon vendoset në bazë të koficientit më të madh nga raporti i pikëve të fituara me atë të humbura, fiton ekipi me koficient më të madh.

Nëse barazimi vazhdon fituesi përcaktohet në bazë të rezultateve të ndeshjeve direkte ndërmjet ekipeve me pike të njëjta

Në rast se Ndeshja regjistrohet me rezultat zyrtar në të mirë të

kundërshtarit , ekipi automatikisht gjobitet me marrjen e një pike.

Ndeshjet regjistrohen me rezultat zyrtar:

- Kur ekipi pa arsye nuk paraqitet ne ndeshje;
- Kur fusha e lojes nuk eshte e pergaditur per loje ose nuk jane plotesuar kushtet tjera per zhvillimin e ndeshjes(te kerkuara nga Gjyqtari i pare dhe Delegati i ndeshjes);, me fajin e ekipit nikoqir,
- Kur ekipi refuzon te zhvillon ndeshjen;
- Kur ekipi paraqitet ne ndeshje me lojtare qe nuk eshte regjistruar sipas akteve normative te FVK-es ose ne kundërshtim me to.
- Kur ekipi paraqitet ne ndeshje me lojtare ,ndaj te cilit udhëhiqet procedura disiplinore(per suspendim ose denim);
- Kur ekipi paraqitet me lojtar i cili nga mjeku eshte shpallur i pa afte per gara ose nuk e ka ne rregulle kontrollin mjekesor.
- Kur ekipi eshte denuar me ndalesa te paraqitjes ne gara;
- Ne rastet tjera qe nuk janë të parapara me këtë nen,vendosë organi kompetent i garave;
- Ndaj ekipit i cili vepron në kundërshtim të këtij Neni udhëhiqet procedura disiplinore.
- Nëse nuk behet pagesa e personave zyrtar para fillimit te ndeshjes.

Neni 7.

Me gara udhëheq Komisarit i garave i FVK-ës
Detyrat e Komisarit të garave janë:

- bënë regjistrimin e ndeshjeve,
- bjen vendime për ankesa në shkallën e parë,
- mbledh shenime për shkëlqen disiplinore të pjesëmarrësve të garave dhe i paraqet komisionit disiplinor,
- vendos për denime dhe suspenzimin e fushave,klubeve, lojtarëve,trajnerëve,gjyqtarëve, delegatëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në ndeshje,
- Jep buletin javor, me rezultate, plasman, vendime dhe informata.
- Lejon ndryshimin e termineve dhe palestrave për zhvillimin e ndeshjes.
- Vendosë për ndryshimin e termineve te ligës për pjesëmarrësit në garat ndërkombëtare,
- Koordinon dhe është përgjegjës për delegimin e gjyqtarëve ,
- Cakton Delegatet-Vëzhguesit në ndeshje,
- Cakton vëzhgues special për ndeshje të caktuara
- Vendosë mbi të gjitha qështjet nga problematika e garave që nuk janë të parapara në Propozicione dhe nuk janë në kundërshtim me aktet normative të FV-ës

Neni 8.

Klubet të cilat kanë të drejtën e pjesëmarrjes në gara ,janë të obliguara që deri në afatin e caktuar të paraqesin Komisarit formullarin e plotësuar për pjesëmarrje të ekipit në ligat e Kosovës.

Neni 9.

Klubi nikoqir është i obliguar të njoftojë zyren e FVK-ës (permes Emailit:info@fvk-ks.org) Komisarin dhe ekipin Kundërshtar me terminin e zhvillimit të ndeshjes deri të Mërkuren,në ora 12,00 ,nese ndeshja luhete ne mesjave zyra njoftohet te henen deri ne ora 12
Në te njejtën kohë ekipi nikoqir është i obliguar të njoftojë kundërshtarin për ngjyren e dresave me të cilën do të paraqitet në ndeshje.
Në qoftëse klubi e ka terminin e perhershëm për zhvillimin e ndeshjeve,është i obliguar të njoftojë pjesëmarrësit e garave për këtë qështje.

Neni 10.

Ndeshjet e ligave të Kosovës zhvillohen,të Premten,të Shtunden ose të dielen:

- Të Premten ndeshjet duhen të caktohen ,ndërmjet 17,00 dhe 20,00
- Të shtunden dhe të dielen ndeshjet duhet caktohen ndërmjet 12,00 dhe 20,00
- Ndeshjet të cilat zhvillohen në mesëjavë (E merkure , E enjte), duhet të caktohen ndërmjet 17,00 dhe 20,00
- Nëqoftëse ndeshjet zhvillohen në mesëjavë,termini xhiros së ardhëshme është e Shtunde ose e Diele

Neni 11.

Ndeshjet luhen në bazë të Rregullave ndërkombëtare.
Në ndeshje udhëheqet protokoli ndërkombëtar i volejbollit.

Neni 12.

Ndeshjet e Super ligen , mund të luhen vetëm në Pallate sportive dhe Palestra të kategorizuara dhe licencuara nga organet kompetente të FVK-ës

Klubi nikoqir është i obliguar të caktojë zhvillimin e ndeshjes vetëm në Palestren të cilën e ka paraqitur për gara dhe e cila i plotëson kushtet e parapara nga organi kompetent i FVK-ës.

Me kerkese te klubit nikoqir,Komisari i Garave i FVK-ës ,mundet me vendim të veçant të lejojë caktimin e ndeshjes në palestren tjeter e cila i plotëson kushtet e parapara nga organi kompetent i FVK

Fushat e licencuara:

Pallatet e sportit: Prishtinë, Prizren, Peje, Gjakove, Mitrovice,Ferizaj, Gjilan,Bardhosh, Lypian ,Suhareke, Diloni Benz, Malisheve,Vushtri,Drenas,

Palestrat: F.SH.S, AAB, Skenderaj (Shkolla e Kompetences në Skenderaj),

- Garat e play ofi-it, play-auti ,finalet e kupave, detyrimisht , do të zhvillohen ne pallate sporti.

Garat ne ligen e Kosoves dhe garat për te rinje dhe te reja, mund te zhvillohen edhe ne salla te shkollave te cilat paraprakisht jane miratuar nga Fvk.

Neni 13.

Me rastin e kontraktimit me kohë të transmetimit të ndeshjes direkte ne TV, ekipet jane te obliguara te respektojne mareveshjen per terminin e caktuar.

14.

Me kërkesë të klubeve, Komisarari i Garave ,mundë të lejonë ndryshimin e termineve ,vendit dhe kohën e fillimit të ndeshjeve.

Në qoftëse ndeshjet e ekipeve të cilat marrin pjesë në garat ndërkombëtare,garat e Kupës së FVK-ës ose garat e grupmohave të reja ,përkojnë me terminet e xhiros së rregulltë, ndeshjet kampionale të këtyre klubeve luhen të Mërkureve ose te enjteve, e cila paraprin xhiros së rregulltë ose me lejen e Komisarit më së voni deri fillim të xhirosë së ardhshme.

Neni 15.

Për hirë të rregullësisë së garave - Komisarari i garave mund të caktoi që ndeshjet e dy javëve të fundit të luhen në të njejten ditë dhe kohë

Neni 16.

Gjysmë ore para fillimit të ndeshjes fusha e lojës duhet të jetë e pregaditur për fillimin e ndeshjes. Gjyqtari i parë dhe Delegati vendosin për kushtet e fushës së lojës, në raste të fuqisë madhore(Vis Major),gjyqtari i parë dhe Delegati vendosin sa janë pengesat e natyrës objektive dhe për fillimin e ndeshjes.

Neni 17.

Obligimet e ekipit nikoqir janë:

- të sigurojë Flamurin e Kosovës dhe FVK-ës
 - të sigurojë top për lojë,
 - të sigurojë protokollin ndërkombëtar,
 - të sigurojë semaforin e dorës, (**me numra 0-30**)pa marr parasyshtë a ekziston semafor elektronik ne palester

- të siguroi stol për lojtar rezerv, trajner dhe mjek.
- Të siguron 3 kujdestar me shenja te caktuar
- Të siguron 5 mbledhës të topave
- Të siguron karrikë për refer kryesor, si dhe
- Të siguroi listen për paraqitjen e lojtarëve dhe trajnerëve.
- Te siguron tabelat per ndrimin e lojtareve per te dy ekipet(prej1-18)
- Te siguron matesin e naltësisë së rrjetës, manometrin dhe termometrin si dhe flamujtë për gjyqtarët e vijave(2 dhe 4)
- Të siguron Mjekun kujdestar me ndihmen e parë.
- Te siguron përfaqësuesin zyrtar të klubit i cili duhet të jetë në disponim të Delegatit dhe Gjyqtarit të parë ,për qeshtje te organizimit të ndeshjes.
- Eshtë i obliguar të paraqesë ndeshjen në organet e MPB dhe të ofron kërkesen e vertetuar dhe të vulosur nga MPB
- Të vendose llogon e sponzorit gjeneral të Ligës, në qoftë se egziston.

Neni 18.

Po qe se organizatorit nuk i ka krye të gjitha këto pregaditje teknike, delegati i ndeshjes cakton edhe 15 minuta në mënyrë që lëshimet të eliminohen.

Vendimi dhe shkaqet për mos zhvillimin e ndeshjes shenohen në protokoll të cilin e nënshkruajnë Gjyqtari i parë , Delegati dhe përfaqësuesit zyrtar të dy ekipeve.

Pengesat e shkaktuara nga fatëkeqësit natyrore,shkatrimi i instalimeve në Palester,mungesa e rrymës në ronë më të gjërë etj. Konsiderohen si fuqi madhore(Vis Major)

Neni 19.

Klubi nikoqir është përgjegjës për organizimin komplet të ndeshjes para dhe pas ndeshjës Në të gjitha rastet kur kushtet e sallës, ndriçimi ose kushtet atmosferike bëjnë të pamundur teknikisht zhvillimin e ndeshjes,atëhere do të procedohet sipas Rregullores Teknike dhe te ketyre Propozicioneve.

Kur nderprerja e ndeshjes e kalon kufirin prej 4 orësh, ajo do të përsëritet ditën e nesërme, duke filluar nga fillimi. Ora e fillimit të ndeshjes do të përcaktohet vetëm nga gjyqtarët e ndeshjes, pas konsultimit me kapitenët e të dyja ekipeve dhe delegatin

Ndeshja që nuk përfundon sipas pikës alinesë paraprake, do të zhvillohet para ndeshjes pasardhëse në një vënd dhe datë, që do të caktohet nga FVK.

Neni 20.

Klubi nikoqir-organizatori i ndeshjes,është i obliguar:

- a) Të siguron, më së voni 1 (një)orë para fillimit të ndeshjes:
 - zhveshtore për personat zyrtar dhe ekipin musafir.
- b) Me përfundim të ndeshjes ,të siguron ambijent të veçant për nevoja të ndryshme administrative (marrja e deklaratave që kanë të bejnë në lidhje me ndeshjen).

Neni 21.

Në ligat e Kosovës mundë të aktivizohen edhe lojtarë me moshë prej 14 vjeçe.

Në ndeshjet e ligave te Kosovës ,lojtarët mundë të aktivizohen me Liçensë të vërtetuar nga mjeku e cila nuk mundë të jetë më e vjetër se 6 muaj.

Në qoftëse nuk e ka liçensën , i lejohet aktivizimi duke e verifikuar identitetin ,me ane te letër njoftimit,pasaportit dhe duke marrë deklaratën e përfaqësuesit te klubit (per arsyetimin e mungeses se

liçenses dhe garantimin e kontrolit dhe vertetimit të mjekut ndërsa klubi ia paraqet liçensën në dispozicion Komisarit të garave në afat prej 48 orëve.

Neni 22.

Paraqitja e trajnerit, udhëheqesit të Statistikes, mjekut, fizioterapeutit, kushtëzohet me liçensimin nga organet perkatese të cilat i udhëheqin garat. (për trajner dhe statistike, nga aktet normative të FVK) (për mjekë dhe fizioterapeut diploma mbi aftësi profesionale)
Në mungesë të liçensës, procedura është e njëjte si në rastin e lojtarëve.

Neni 23.

Gjatë ndeshjes në tavolinën e proqesmbajtësit mund të ulën vetëm delegati, proqesmbajtësi me ndihmësin e tij për rrotullimin e semaforit si dhe mjeku kujdestar në ndeshje.
Gjatë ndeshjes në stolin për lojtarët rezerv mund të ulën vetëm lojtarët e lajmëruar (evidentuar) në protokoll, trajneri i parë dhe i dytë si dhe mjeku i skuadrës.

Neni 24.

Për çdo ndeshje të ligave të Kosovës Delegatin e ndeshjes e cakton Komisari i garave i FVK-es
Në të gjitha ndeshjet e ligave të Kosovës, gjyqtarin e parë të Dytë dhe gjyqtaret e vijave, i cakton Komisari i Garave
Sekretari (procesmbajtësi) dhe gjyqtaret e vijave duhen të kenë provimin e dhënë për gjyqtar.
Për ndeshjet e PLAY –Off, Play Aut dhe Finale të Kupës së Kosovës, caktohen nga 2 ose 4 gjyqtarë të vijave.

Neni 25.

Paisjet e lojtarëve duhet të përgjigjen rregullave ndërkombëtare të lojës dhe të gjithë lojtarët duhet të kenë pajisjet e njëllojshme, (përveq Liberos)
Ekipi musafirë, (përveq Liberos) duhet të paraqitet me fanela me ngjyrë të ndryshme nga ngjyra bazë e ekipit nikoqir.

Neni 26.

Gjyqtaret janë të obliguar 1 orë para fillimit të ndeshjes të paraqiten Delegatit, kurse, 30 minuta para fillimit të ndeshjes me paisje (uniforme) komplete të paraqiten delegatit dhe përfaqësuesve të klubeve .
Poqese Gjyqtari i parë i caktuar nuk paraqitet në ndeshje, atë do ta Zvendësojë Gjyqtari i dytë, kurse Gjyqtarin e dytë, Gjyqtari i rangut të njëjte i cili gjindet në sallë ,me pelqimin e klubeve duke konstatuar në protokoll para fillimit të ndeshjes me nënshkrimin e kapitenëve
Në qoftë se në ndeshje nuk paraqiten asnjëri nga gjyqtaret e deleguar, mund të zvendësohen me dy gjyqtarë tjerë ,te rangut të njëjte, prezent në Palester , në baze të marrëveshjes të klubeve duke konstatuar në protokoll para fillimit të ndeshjes me nënshkrimin e dy Kapitenëve të ekipeve.
Në qoftëse nuk vjete deri të pelqimi i klubeve ose nuk ka mundësi të zvendësimit të njerit ose të dy gjyqtarëve, do të caktohet termin tjetër për zhvillimin e ndeshjes ose do të veprohet në baze të vendimit të Komisarit të Garave ,mvarësisht nga rasti konkret.

Neni 27.

Gjyqtari i parë i kryen të gjitha detyrat e delegatit në ndeshjet e ligave të Kosovës, po që se delegati i deleguar nuk vjen në ndeshje

Neni 28.

Me përfundimin e ndeshjes Kapitenët e të dy ekipeve janë të obliguar të nënshkruajnë protokollin, protokollin udhëhiqet në tri kopje ,origjinali i dërgohet Komisarit të garave të FVK-ës, ndërsa nga një kopje përfaqësuesve të ekipeve.

Neni 29.

Në ndeshjen dhe në rezultatet e ndeshjes (shkeljes së Propozicioneve të garave) si dhe rregullave ndërkombëtare të lojës është e lejuar ankesa
Ankesën duhet paralajmëruar në protokoll duke arsyetuar me motivet themelore pasë mbarimit të ndeshjes dhe para nënshkrimit të protokollit.

Neni 30.

Arsyetimin me shkrim të ankesës dhe pagesën e taksës (50€) duhet adresuar Komisarit të garave ma së voni 48 orë pasë perfundimit të ndeshjes.

Në qoftë se klubi hjekë dorë nga ankesa e paralajmëruar në protokollin e ndeshjes së zhvilluar, i njejti është i obliguar të njoftonë Komisararin e garave te FVK-es në afat prej 24 orëve.

Ankesat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e cekura ,nuk do të mirren në shqyrtim dhe do të refuzohen .

Neni 31.

Ankesa e cila ka të bëjnë në lidhje me pjesëmarrjen e lojtarit i cili nuk ka të drejt loje, për parregullsitë e fushës së lojës,për temperaturën e ajrit ose e dritave, paraqitet para fillimit të ndeshjes.

Neni 32.

Komisari i garave i FVK –ës bjen vendimin për ankesë në afat prej, ma së voni, 5 ditë prej ditës së pranimit të ankesës.

Neni 33.

Në vendim të Komisarit të garave të FVK-ës mund të parashtrohet ankesa në afat prej 3 ditë prej ditës së pranimit të vendimi.

Ankesa në shkallën e dytë (Bordit) bëhet kundrejtë pagesë të taksës (150€).

Ankesa e shkallës së dytë e prlongon zbatimin e dënimit, përveq në rastin e suspendimit.

Vendimi i shkallës së dytë(Bordit) duhet pruar Brenda 8 ditë prej ditës së pranimit të ankesës.

Vendimi i shkallës së dytë është definitive.

Neni34.

Personave zyrtar të caktuar në ndeshjet e ligave të Kosovës, u takon taksa e referimit, meditja dhe shpenzimet e rruës, (e njejta gjë vlenë edhe për ndeshjet të cilat për ndonji arsye janë ndërprerë).

Në qoftë se ndeshja nuk zhvillohet ,personave zyrtar u takon 50%nga taksa e caktuar ,mëditja dhe shpenzimet e rrugës.

Për “vëzhguesi special” shpenzimet i bartë FVK-ës.

Neni 35.

Para fillimit të ndeshjes, klubi nikoqir i pagon taksën e referimit, shpenzimet e rrugës dhe mëditjet e personave zyrtar.

Neni 36 .

Klubeve te Super ligave të Kosovës ju rekomandohet që të udhëheqin statistiken në ndeshje dhe eventualisht të organizojnë Press-konference ,me perfundimin e ndeshjes.

Neni 37.

Nga pagesa e klubeve pjesëmarrës në ligat e Kosovës (kotizimi), mbulohe :

- Shpenzimet e mbledhjeve te Kuvendit të FVK-ës
- Shpenzimet e mbledjeve të Bordit,dhe organeve dhe Komisioneve të FVK-ë
- Kompensimi për Sekretarin,(Administratorin),

- Shpenzimet e zyrës, telefoni, etj. dhe
- Shpenzimet tjera në kuadër të FVK-ës.

Neni 38.

Komesari i garave të FVK-ës udhëheqë procedurat, vendosë për suspendimet, dënimet mandatare dhe dënimet për shkeljen dhe mos respektimin e neneve të këtyre Propozicioneve të garave.

Neni 39.

Mos shlyerja e obligimeve financiare dhe pagesave të dënimeve mandatare në kohën e parapar, gjegjësisht në afatin e caktuar, automatikisht tërheqë suspendimin nga garat.

Komisari i Garave, në bazë të këtyre Propozicioneve, vendosë për sanksionet për mos shlyerjen e obligimeve.

Neni 40.

Shkeljet e kryera në kundërshtim me dispozitat e Rregullores së garave dhe akteve tjera normativ të cilat nuk janë përfshirë me këtë Propozicion të garave, i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore, në përputhje me Rregulloren disiplinore dhe materiale të FVK-ës.

Komisari i garave të FVK-ës, mbledhë prova të veçanta dhe bënë paraqitjen për procedurë, ndërsa procedurën e udhëheq gjyqtari Disiplinor i FVK-ës.

Neni 41.

Pjesëmarrësi në gara i larguar deri në fund të ndeshjes, automatikisht suspendohet dhe denohet me mos lojë në ndeshjen e radhës në ligat e FVK-ës dhe dënimin e klubit me jobë në të holla.

Neni 42.

Klubi i cili pa arsye nuk paraqitet në dy (2) ndeshje, largohet nga garat e mëtutjeshme.

Klubi i cili është larguar nga garat, mundë të aktivizohet në një ligat e ragut më të ultë (nëse ka) në Stinorin e ardhshëm vetëm kur i shlyen të gjitha obligimet ndaj FVK-ës, me largimin nga garat (të mbetura nga Stinori paraprak)

Neni 43.

Kodeksi i sljelljes

Neni 44.

Dispozitat e Rregullores së Brendshme të FVK-ës, Rregullores mbi regjistrimin e klubeve dhe lojtrëve të voleybollit, Rregullores mbi përgjegjësinë Disiplinore dhe materiale të FVK-ës dhe akteve tjera normative dhe vendimeve të FVK-ës, do të zbatohen për të gjitha pyetjet të cilat nuk janë rregulluar me këto Propozicione.

Neni 45.

Sqarimet në lidhje me këto Propozicione janë në kompetencë të Komisarit të garave të FVK-ës.

Neni 46.

Pjesën integrale të këtyre Propozicioneve e përbëjnë:

- Aneks Propozicionet e ligave të FVK-ës (super liga dhe liga e parë),për edicionin garaues 2015/2016
- Lista e gjyqtarëve dhe Delegatëve për edicionin 2015/2016
- Udhëzimi dhe detyrat e Delegatit – Vëzhguesit në ndeshjet e Super ligave(m&f).

Neni 47.

Keto Propozicione te garave të FVK-ës për Edicionin 2015/2016,hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Bordi , në vazhdimësi deri në Edicioni 2016/2017.

Prishtinë / Shtator/ 2015

Kryetari i FVK-ës
